

Vendim
Nr.680, datë 10.10.2007

Për disa ndryshime në vendimin nr.857, datë 20.12.2006 të këshillit të Ministrave “Për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

Vendosi:

Në vendimin nr.857, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Ministri i Shëndetësisë, brenda datës 10 tetor 2007, miraton statutin tip të qendrave shëndetësore.”.

2. Fjalja e dytë e pikës 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Të ardhurat e krijuara nga shërbimet e ofruara, sipas kësaj pike, përdoren sipas përcaktimeve, me udhëzim të përbashkët të nxjerrë për këtë qëllim, të Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Financave.”.

3. Në shtojcën 2 që i bashkëlidhet vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Në fillim të fjalisë së parë të nenit 6, fjalët “Paketa minimale e shërbimeve, që duhet të ofrojë QSH-ja...”. zëvendësohet me “Paketa e shërbimeve shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor...”.

b) Në paragrafin e katërt të nenit 12, fjalja “Kjo shumë të shpërndahet për çdo qendër shëndetësore, në bazë të numrit të banorëve të regjistruar.” zëvendësohet me “Kjo shumë të shpërndahet për çdo qendër shëndetësore, në bazë të realizimit të treguesve të cilësisë së shërbimeve.”.

c) Neni 23 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 23

Për çdo njësi të qeverisjes vendore, respektivisht bashki/minibashki a komunë, ngrihet dhe funksionon bordi i qendrës shëndetësore (BQSH), i cili e ushtron veprimtarinë në

territorin e kësaj njësie. Ky bord ka në përbërje drejtorin e shëndetit publik/autoritetin shëndetësor rajonal ose përfaqësuesin e caktuar prej tij, drejtorin e drejtorisë rajonale të sigurimeve të kujdesit shëndetësor ose përfaqësuesin e caktuar prej tij dhe përfaqësuesin e njësisë së qeverisjes vendore, në territorin e së cilës ushtron veprimtarinë qendra shëndetësore.

Bordi mbledhet jo më shumë se 4 herë në vit. Bordi mund të mbledhet edhe jashtë radhe, për raste të veçanta. Detyrat e bordit të qendrës shëndetësore janë:

- Organizimi i konkurrencës për përzgjedhjen e drejtorit të qendrës;
- Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit;
- Shqyrtimi i ankesave për emërimin e drejtorit dhe për shërbimin që ofron kjo qendër;
- Miratimi i procedurës së punësimit dhe të largimit të personelit;
- Miratimi i donacioneve, që jepen për qendrën.”.

ç) Shkronja “dh” e nenit 24 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Drejtori i qendrës shëndetësore punëson dhe shkarkon personelin e kësaj qendre. Bordi i qendrës shëndetësore kontrollon procedurën e punësimit dhe të shkarkimit të personelit dhe autorizon drejtorin e kësaj qendre për lidhjen e kontratës së punës, në përputhje me nenin 12 të Kodit të Punës.”.

d) Në fund të paragrafit të parë të nenit 25, fjalët “...së bashku me statutin tip të qendrës shëndetësore...” hiqen.

dh) Paragrafi i dytë i nenit 31 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Qendra shëndetësore detyrohet t’i paraqesë DRSKSH-së dhe DSHP-së/autoritetit shëndetësor rajonal të gjitha të dhënat e kërkuara prej tyre, si të dhënat nga monitorimi i kapacitetit, produktivitetit, efektivitetit, cilësisë, siç përcaktohet në udhëzimin e Ministrisë të Shëndetësisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri

Sali Berisha